



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

***Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore***

*Adresa: Bulevardi "Abdi Toptani", nr.3, Tiranë;*

*E-mail: klsh.org.al; Web-site:www.klsh.org.al*

Nr. 219/6 Prot.

Tiranë, më 30.07.2018

**V E N D I M**

**Nr. 95, datë 30.07.2018**

**PËR AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË  
NË AVOKATURËN E SHTETIT TIRANË**

Nga auditimi i ushtruar në Avokaturën e Shtetit, u konstatuan të meta dhe mangësi në drejtim të zbatimit të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", si dhe mungesë e marrjes së masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin e mëparshëm të auditimit. Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, me shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm në KLSH, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Mbi Auditimin e Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë*", në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit Tiranë sipas Programi të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 219/1, datë 09.03.2018, i ndryshuar.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

## **OPINIONI I AUDITIMIT**

Nga auditimi i kryer në Avokaturën e Shtetit sipas ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, si dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale për nga sasia, **por janë materiale për nga konteksti**<sup>1</sup>, të cilat konsistojnë si më poshtë:

**1.** Nga auditimi mbi përzgjedhjen e studiove ligjore të huaja për mbrojtjen e Shtetit shqiptar nga padite e dy kompanive të huaja në arbitrazhet ndërkombëtare, e konkretisht kompanitë AAGL dhe EFT, të cilat kanë paditur respektivisht Ministrinë e Financave dhe OSHEE, KLSH konstaton se çështjet nuk kanë karakter të veçantë teknik që të mbrohen nëpërmjet përzgjedhjes dhe kontraktimeve me studio të huaja ligjore. Përzgjedhja e këtyre studiove në kundërshtim me ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 dhe VKM nr. 392, datë 08.04.2009, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale” ka sjellë si pasojë rritje artificiale të shpenzimeve buxhetore në shumën prej **3,740,000 euro**.

**2.** Nga auditimi për respektimin e dispozitave ligjore për lidhjen e dy kontratave me studiot ligjore private të huaja në vlerën prej 2,340,000 euro, në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8 të ardhurat e tatueshme, kreu IV “Tatimi i mbajtur në burimin e të ardhurave, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” pika 1, nuk ka parashikuar kryerjen e ndalesës së tatimit në burim në masën 15 % mbi të ardhurat e realizuara në shumën **351,000 Euro**, duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë nga studiot ligjore dhe evazion fiskal për të ardhurat buxhetore.

**3.** Nga verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimit të mëparshëm me shkresë të KLSH-së, nr.264/8, datë 12.10.2015, në lidhje me arkëtimin e garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “Vetro Energy PTE Ltd” në procedurat e zhvilluara për privatizimin e shoqërisë “A.” sha, Patos”, rezultoi që nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për realizimin e rekomandimit të lënë nga KLSH.

Midis Avokaturës së Shtetit dhe ish-MZHETTS, sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pasur disa korrespondenca në lidhje me këtë problematikë, me shkresat nr. 8276/2, datë 30.10.2015; nr. 8291/2, datë 20.11.2015; nr. 2564/1, datë 30.05.2016 dhe nr. 7992/1, datë 14.10.2016, me të cilat është kërkuar marrje informacioni për dosjen e privatizimit të A. sh.a, dhe jo mbi ecurinë për të përsheptuar nga ana ligjore mundësimin

<sup>1</sup>ISSAI 1320: Përcaktimi i materialitetit për nga konteksti përfshin gjykimin profesional të audituesit, i cili ndikohet nga kuptueshmëria që ka audituesi për entitetin që po auditohet, procedurat e vlerësimit të riskut, si dhe natyrës dhe shkallës së shkeljeve të konstatuara

e arkëtimit të garancisë së kontratës, në vlerën **85 milion Euro** nga Vetro Energy PTE Ltd”, duke vazhduar dhe riskuar të humbasin kohë, që të kalojnë të gjitha afatet procedurale, dhe për pasojë çështja të bëhet e pakërkueshme, rrjedhojë kjo e artificeve procedurale administrative të burokracisë së brendshme të institucioneve të Shtetit Shqiptar.

**4.** Nga auditimi mbi vlerësimin e realizimit të aktivitetit për vitin 2016 të Zyrës së Përfaqësimit të Avokaturës së Shtetit pranë gjykatave shqiptare në nivel kombëtar, u evidentuan raste juridike që kanë sjellë çështje gjyqësore të humbura, në disfavor të Shtetit Shqiptar, të shkaktuara si pasojë e mangësive dhe dobësive të vendimeve dhe akteve juridike-administrative të institucioneve të administratës publike.

Avokatura e Shtetit, ndonëse i ka përfaqësuar çështjet juridike, që në fillim i ka konsideruar dhe vlerësuar si çështje juridike të humbura, për shkak të mangësive dhe dobësive të akteve juridike-administrative të institucioneve të administratës publike, të përgatitura nga punonjës të pakualifikuar dhe të papërgjegjshëm. Këto veprime të administratës shqiptare kanë sjellë rëndimin e mëtejshëm të shpenzimeve buxhetore, në vlerën prej **69,443,100 lekë** e barazvlefshme me 15%, të vlerës totale prej 462,954,000 lekë ndaj dëmit të shkaktuar në Buxhetin e Shtetit nga çështjet e humbura.

#### **Opinion i kualifikuar:**

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standartet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Avokatura e Shtetit u konstatuan devijime dhe shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën **japim opinion të kualifikuar.**

## **A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME LIGJORE**

**Gjetje 1.** Nga auditimi konstatoam se Ligji nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” ka qenë pjesë e paketës së reformës në drejtësi, në përputhje me dokumentin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri. Nga verifikimi i kalendarit të punimeve të Kuvendit të Shqipërisë, rezulton se paketa e ligjeve ka kaluar për miratim, ndërsa ky ligj nuk është miratuar. Gjithashtu, ndryshimet e propozuara në këtë ligj janë diskutuar në Komisionin e Reformës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit, por deri në momentin e hartimit të Projekt-Raportit të auditimit, Kuvendi i Shqipërisë nuk kishte miratuar ndryshimet në ligj.

Ky projektligj ka si qëllim fuqizimin e rolit të Avokaturës së Shtetit për përfaqësimin e interesave pasurorë të Shtetit dhe dhënies së asistencës për organet shtetërorë, nëpërmjet këshillimit në procedurat paraprake të hartimit dhe lidhjes së kontratave nga institucionet publike.

Duke qenë se projektligji synon të bëjë disa ndryshime thelbësore në funksionimin e institucionit të Avokaturës së Shtetit, domosdoshmëria e të cilave u konstatua në auditimin e mëparshëm të KLSH dhe në këtë auditim, duhet ndërmarrë nisma ligjore për pasqyrimin

e këtyre ndryshimeve dhe në VKM me nr. 392, datë 08.04.2009, *trajtuar më hollësisht në faqet 20-21 të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të marrë masa, në bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Kuvendin e Shqipërisë, për shqyrtimin nga Kuvendi të ndryshimeve ligjore të propozuara prej saj dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

**Menjëherë**

**Gjetje 2.** Nga auditimi i kryer, u konstatua se në VKM nr. 392, datë 08.04.2008 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”, neni 13 dhe 14, ndër të tjera parashikohen edhe kriteret e përgjithshme për përzgjedhjen e kompanisë konsulente fituese për të përfaqësuar interesat e Shtetit Shqiptar. Këto kriteret janë me karakter përgjithësues, duke lënë hapësira të konsiderueshme që përzgjedhja e kompanisë fituese të jetë subjektive dhe e pa mbështetur në evidencat përkatëse, *trajtuar më hollësisht në faqet 28-33, të Raportit Përfundimtar.*

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Me qëllim përmirësimin e procedurës së kontraktimit, Avokatura e Shtetit të hartojë dhe miratojë një akt të brendshëm (udhëzim/manual), në zbatim të VKM nr. 392 datë 08.04.2008, ku të parashikohen në mënyrë specifike dhe të detajuar, sa më poshtë:

- a. Kriteri “çmim” i konsulencës të llogaritet duke ju referuar kontratave të ngjashme që Shteti Shqiptar ka lidhur, ose, në mungesë të tyre, të bazohet në tarifa të kontratave me karakter të ngjashëm në tregun privat të vendit. Vlen të theksohet se, në hartimin e kriterit “çmim” duhet të merren parasysh edhe kufijtë brenda të cilave buxheti i Shtetit Shqiptar i ka mundësitë financiare për të paguar një zyrë të huaj avokatie për këtë përfaqësim në arbitrazhin ndërkombëtar, pra të vendosen tavane tarifash në dërgimin e ftesës për negociata.
- b. Kriteri “specialiteti” (ekspertiza profesionale) nevojitet të detajohet, në mënyrë që konkurrentët të ofertojnë duke faktuar njohuritë që disponojnë në fushën e kërkuar të ekspertizës, nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve/evidencave përkatëse të mjaftueshme dhe të besueshme, dhe jo thjesht nëpërmjet një deklaratë pohuese nga ana e ofertuesit, sikundër është vepruar deri tani. Vetë deklarimi në këto raste nuk është evidencë e mjaftueshme dhe e besueshme për të marrë siguri mbi vërtetësinë e pohimit (aftësitë e provuara të ekspertizës).
- c. Kriter bazë për përzgjedhjen e studiove ligjore të avokatisë të jetë “numri i çështjeve të fituara në raste dhe procedura të ngjashme”, të cilat të faktohen me dokumente/evidenca përkatëse të mjaftueshme dhe të besueshme dhe (si psh. vendime të arbitrazhit ndërkombëtar të fituara në fushën e kërkuar të ekspertizës), dhe jo thjesht nëpërmjet një deklarate pohuese, sikundër është vepruar deri tani.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**B. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE**

**Gjetje 1.** Nga auditimi mbi hartimin, programimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2017 me objekt programimin e fondit limit të rikonstruksionit të ambienteve të

godinës së Avokaturës së Shtetit, u konstatua se projekti dhe preventivi për rikonstruksionin e godinës ku është transferuar Avokatura e Shtetit, kati i IV dhe i V ishte përlogaritur në vlerën prej 27,218,000 lekë, sipas kërkesës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (pasi ndajnë të njëjtën godinë me kahe të kundërta) dhe të mbikëqyrësit të punimeve (i cili ka ndjekur punimet e pjesës së Komisionerit). Kjo kërkesë është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 15688, datë 09.11.2017, bashkëngjitur Aktin normativ nr. 3, datë 06.11.2017, nënshkruar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, duke çelur në llogarinë 231 fondin për investime me objekt “Rikonstruksion i godinës së Avokaturës së Shtetit” në vlerën prej 47,515,000 lekë, ose 20,297,000 lekë më tepër se preventivi i kërkuar përfundimtar, veprim i cili përbën ngurtësim të fondeve publike dhe mosrealizim të investimeve në sektorë të tjerë të ekonomisë, trajtuar më hollësisht në faqet 8-9 të Raportit Përfundimtar të auditimit.

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit, pas përfundimit të fazës së programimit të fondeve sipas artikujve dhe nënartikujve, të marrë masa për rakordimin me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave që, për çdo devijim në fondeve krahasuar me preventivat e hartuara dhe të miratuara, të kërkojë sistemimin e tyre, me qëllim eliminimin e veprimeve që rrezikojnë përfundimin e punimeve, apo ngurtësimin e tyre në dëm të investimeve në sektorë të tjerë të ekonomisë.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 2.** Nga auditimi i shpenzimeve operative (llogaria 602), konstatohet se për periudhën objekt auditimi, Avokatura e Shteti ka marrë pjesë në procedura gjyqësore dhe arbitrazhe të ndryshme të zhvilluara në shtete të huaja, për të cilat janë kryer pagesa për “udhëtim e dieta” në vlerën totale prej 4,209,061 lekë, nga të cilat shpenzimet e udhëtimit (biletat) zënë rreth 49 % dhe shpenzimet e akomodimit (fjetje në hotel) zënë rreth 51 %.

Nga verifikimi i kryer për çdo praktikë shërbimi, konstatohet se dokument justifikues për likuidimin e shpenzimeve të fjetjes në hotel ka shërbyer një fletë formati A4 me emërtimin “rezervim hoteli”, e printuar nga agjencia private e kontraktuar (A T & T ), e pajustificuar me faturën origjinale të hotelit për netët e fjetjes, ku të përcaktohet vlera faktike e paguar nga punonjësi pas kthimit nga shërbimi.

Kjo mënyrë veprimi lë shteg për përdorim pa efektivitet të fondeve publike, pasi është në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit pika 11, ku përcaktohet: “Shpenzimet e transportit, të fjetjes dhe pagesat e tjera, në të gjitha rastet, njihen dhe paguhen sipas dokumentit përkatës justifikues”, trajtuar më hollësisht në faqet 13-14, të Raportit Përfundimtar të auditimit.

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Marrjen e masave për të përcaktuar rregulla dhe kritere të reja konform VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit sipas pikës 11, ku cilësohet: “Shpenzimet e transportit, të fjetjes dhe pagesat e tjera, në të gjitha rastet, njihen dhe paguhen sipas dokumentit përkatës justifikues (të hotelit)” dhe pikës 9 për të diferencuar kategoritë e punonjësve për shpenzimet e fjetjes në hotel, sipas numrit të yjeve.

**Gjetje 3.** Për periudhën objekt auditimi janë kryer pagesa për mbulimin e shpenzimeve të telefonit celular për znj. A. H. respektivisht 10,000 lekë për çdo muaj. I pashpjegueshëm mbetet rimbursimi i këtyre shpenzimeve sipas faturave përmbledhëse me emërtimin Studio Ligjore “H & H ” në Rr. Dëshmorët e Kombit Twin Towers nr.2 kati 9 ap 9/1. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 24, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", "Konflikti i interesave" ku përcaktohet: *“Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, si dhe çdo avokat i shtetit nuk mund të përfaqësojnë shtetin, në rast se ka interesa, të njohura ose jo publikisht, për çështjen në gjykim, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.* (procese të cilat zhvillohen edhe me pjesëmarrjen e avokatëve privatë), *trajtuar më hollësisht në faqet 14-15, të Raportit Përfundimtar.*

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të marrë masa për ndryshimin e adresës apo numrit celular që përdor në emër të studios së avokaturës “H & H ”, me qëllim respektimin e nenit 24, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", "Konflikti i interesave".

**Menjëherë**

**Gjetje 4.** Për periudhën objekt auditimi janë kryer shpenzime në vlerën totale prej **144,740 lekë** për dërgim nëpërmjet Postës Shqiptare të 11 materialeve zyrtare në disa zyra apo studio avokatie me seli në disa shtete të ndryshme si; Itali, Zvicër, Suedi, New York dhe deri në Singapor. Për këto korrespondenca u kërkua informacion në protokollin e institucionit me qëllim evidentimin e çështjeve për të cilat është interesuar Shteti Shqiptar, por nga protokollin nuk na u paraqit asnjë informacion për problemet e lindura dhe marrëdhëniet midis tyre dhe Avokaturës së Shtetit. Kjo mënyrë veprimi tregon mungesë transparence nga Avokatura e Shtetit në lidhje me marrëdhëniet që krijohen midis institucionit (ASH) me studiot avokatore me seli në shtete të ndryshme, *trajtuar më hollësisht në faqen 17, të Raportit Përfundimtar.*

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Marrjen e masave për administrimin e kopjes së të dhënave për çdo korrespondencë me studiot e avokatisë si dhe krijimin e databass-eve të veçanta për çështje të ndryshme sipas nenit 22, pika 2 e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", ku përcaktohet se: *"Arkivat shtetërore vendore janë të detyruar të regjistrojnë çdo pasuri dokumentare joadministrative, që ekziston në territorin e njësisë së tyre..."*.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 5.** Kompania publike “A.” sh.a dhe ish MEI përfaqësuar nga AKBN kanë në zbatim marrëveshjen Hidrokarbure të lidhur me B P A (BPAL) për zhvillimin dhe prodhimin e naftës në vendburimin Patos-Marinez. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, “A.” sh.a dhe AKBN kanë ngritur pretendimi për mosrespektim të marrëveshjes nga BPAL. Pretendimi konsiston në mos njohjen e **600 milionë USD** nga “A.”, dhe AKBN të disa kostove hidrokarbure të kryera nga BPAL, në kundërshtim me

marrëveshjen hidrokarbure. Për këtë pretendim, BPAL, në shtator 2015 ka paraqitur kërkesë për arbitrazh ndërkombëtar të ICC (International Chamber of Commerce) kundër MIE/AKBN dhe A. sh.a. Për të mbrojtur këtë çështje, A. sh.a, me shkresën nr. 7935/2, datë **13.11.2015**, i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit që kontraktimi për shërbimet e përfaqësimit dhe mbrojtjes, të zhvillohet në mënyrë të pavarur nga vetë A., sh.a. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me shkresën me nr. 1714/31, datë **16.11.2015** i është drejtuar ish-Ministrin të Energjisë dhe Industrisë dhe “A.”sh.a dhe sugjeron që kontraktimi i shërbimeve të përfaqësimit dhe mbrojtjes nga studio avokatie e huaj/vendase të zhvillohet në mënyrë të pavarur nga vetë “A.”sh.a. Ky mosveprim i Avokaturës së Shtetit, duke mos e përfaqësuar dhe mbrojtur Shtetin në këtë çështje, është në kundërshtim të hapur me nenin 15 pika 8 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokatin e Shtetit” dhe me nenin 11, Kreu IV dhe nenin 16.2 të VKM nr. 392, datë 08.04.2009 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme”. Është në kundërshtim flagrant, pasi Avokatura e Shtetit zotëron të gjithë kompetencën juridike të nevojshme për mbrojtjen me profesionalizëm të kësaj çështjeje me rëndësi të madhe në përfitim të të ardhurave publike.

- Mirëpo, pas tre ditësh, më datë **19.11.2015**, Avokatura e Shtetit, me shkresën nr.1714/35, i kërkon Ministrin të Drejtësisë të japë miratimin për përzgjedhje të përfaqësimit dhe mbrojtje në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICC case no 21349/EMT, pra brenda një periudhë shume të shkurtër, ka vepruar me dy standarte, duke realizuar dy veprime administrative që kundërshtojnë njëra tjetrën, në njërin sugjeron kontraktimi i shërbimet të bëhet në mënyrë të pavarur nga A. dhe në tjetrën i kërkon Ministrin miratim për përzgjedhje të përfaqësimit dhe mbrojtje në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar.

- Në vijim, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me shkresën urgjent nr. 1714/56, datë **07.01.2016**, informon Ministrin e Drejtësisë dhe Ministrin e Energjetikës dhe Industrisë se Avokatura e Shtetit ka sugjeruar që firma C., M.-P., C. & M. LLP të kontraktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me VKM me përfaqësim të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe të Agjencisë Kombëtare e Burimeve Natyrore, në këtë çështje arbitrazhi, krahas përfaqësimit nga vetë A.. Por ,sipas konstatimit në AKBN në datën 27.11.2015, A. sh.a, **me miratim të Avokaturës së Shtetit, tashmë e kishte lidhur kontratën e përfaqësimit me studion e huaj ligjore C., M.-P., C. & M. LLP , çka do të thotë që de jure dhe de facto, ky shërbim avokatie i është dhënë drejtpërdrejt studios së huaj ligjore C., M.-P., C. & M. LLP .**

Sugjerimi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për të ligjëruar miratimin e kontratës nëpërmjet VKM, tregon qartë veprimet apo mosveprimet e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, në shkelje të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokatin e Shtetit”, në lidhje me kontraktimin e kësaj studio avokatie, ***pa realizuar me parë procedura konkurrimi.*** Kjo tregohet qartë edhe në vijim të kryerjes së shërbimit të përfaqësimit për këtë çështje, të realizuar nga studio ligjore C., M.-P., C. & M. LLP :

AKBN, me shkresën nr.3927, datë **06.05.2016**, i ka kërkuar Avokaturës së Shtetit të bëjë interpretimin juridik, të shkresës nr. 3036, datë 05.05.2016, të “A.” sh.a, me të cilën i kërkon AKBN-së të kryejë pagesën përkatëse për shërbimet e marra nga “C. &M.”, në kuadër të procesit të Arbitrazhit ICC 21349/EMT. Për këtë, Avokati i Përgjithshëm i

Shtetit, me shkresën nr.212/1, datë 06.05.2016, i kthen përgjigje dhe e këshillon se “...kur shërbimet kanë qenë të pandashme, për shkak të strategjisë së mbrojtjes me përfitim direkt të të tre palëve, duket i arsyeshëm pretendimi i A. për ndarje të kostove ndërmjet palëve përfituese”. Dhe, në zbatim të kontratës AKBN i ka paguar studios ligjore vlerën prej 1,351,370.48 USD nga detyrimi total prej 1,358,421.54 USD, ndërsa vetë A. sh.a i ka paguar vlerën prej 46,527.09 USD nga detyrimi total prej 102,378.00 USD.

Sa sipër, kontraktimi i këtij shërbimi pa procedura konkurrimi, në kundërshtim me ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, ka sjellë gjatë zbatimit të kontratës dhe do të sjellë në vijim rritje të kostos së këtij shërbimi. Konkretisht, konstatohet se studio ligjore “C. M.-P., C.&M. LLP” ka pezulluar shërbimin juridik dhe mbrojtjen në arbitrazhin ndërkombëtar të çështjes ICC case no 21349/EMT, për shkak të mos-pagesave në kohë të faturave financiare nga “A.”sh.a, duke rritur pritshmërinë e hapjes së një çështjeje tjetër në arbitrazhin ndërkombëtar, që do të sjellë si pasojë rritje të kostos financiare për studion ligjore “C.M.-P., C.&M. LLP”, ku burim i financimit do të jenë përsëri të ardhurat publike që sigurohen nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të Shqipërisë.

Pra, veprimet e mësipërme, korrespondenca zyrtare në lidhje me çështjen ICC case no 21349/EMT nga ana e Avokaturës së Shtetit, tregojnë status juridik kontradiktor në kalim të kompetencës, duke i dhënë miratimin “A.”sh.a, në kundërshtim me ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, neni 2, “Avokatura e Shtetit” dhe VKM nr. 392, datë 08.04.2009 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme”.

Avokatura e Shtetit e justifikon rastin konkret me mungesën e plotësimit të organikës së Zyrës së përfaqësimit për gjykatat huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, pasi në strukturën organike të institucionit të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 150, datë 10.11.2015, i ndryshuar, zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja ka në organikë 6 (gjashtë) avokatë të Shtetit, por faktikisht është plotësuar vetëm me 1(një) avokat të Shtetit, *trajtuar më hollësisht në faqet 55-57, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

### **Për sa më sipër rekomandoj:**

**1.** Për çdo rast kur kërkohet mbrojtje e çështjeve në arbitrazhet ndërkombëtare, Avokatura e Shtetit të kontraktojë studio ligjore avokatie apo konsulence, nëpërmjet realizimit të procedurave të konkurrimit dhe paraprakisht mbështetur në fondet publike që ka në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, ose të garantuara nga subjektet publike që kanë interesa dhe janë pale në arbitrazh.

### **Në vazhdimësi**

**2.** Për çdo rast të kontraktimit të studiove ligjore avokatie apo konsulence për mbrojtje të çështjeve në arbitrazhet e ndryshme ndërkombëtare nëpërmjet konkurrimit, Avokatura e Shtetit të bashkëpunojë ngushtë me subjektet publike që janë palë në këto çështje për hartimin e dokumenteve të konkurrimit, (kriterëve të përgjithshme, kriterëve specifike dhe kushtet e kontratave). Dhe për çdo rast, t’i referohet edhe rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë të Shtetit në këto subjekte apo rekomandimeve të lëna nga strukturat e Auditimit të Brendshëm.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**



3. Avokatura e Shtetit të merren masa të menjëhershme për të nxitur rekrutimin e punonjësve (avokatëve të Shtetit) nëpërmjet krijimit e kushteve stimuluese duke marrë iniciativa ligjore në lidhje me:

-Rritjen e nivelit të pagës të avokatëve të Shtetit, duke e çuar në nivelet e pagës së punonjësve të administratës së lartë shtetërore.

- Përmirësimin e kërkesave kufizuese për punësimin e avokatëve të Shtetit, të përcaktuara në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokatin e Shtetit”, për të vendosur kërkesa rekomanduese për punësimin e tyre.

-Avokati i Shtetit të fillojë procedurat e rekrutimit të avokatëve të tjerë për plotësimin e organikës me 5 avokatë shtetërore në zyrën e përfaqësimit në gjykatat e huaja, në zbatim Urdhër të Kryeministrit nr. 150, datë 10.11.2015.

## Menjëherë

**Gjetje 6.** Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH (me shkresë të KLSH me nr.264/8, datë 12.10.2015), në lidhje me arkëtimin e garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “V.E. PTE Ltd” për procedurën e zhvilluar për privatizimin e shoqërisë “A.” sha, Patos”, KLSH ka rekomanduar: *“Të vazhdojë me përparësi ndjekja e procedurave ligjore brenda dhe jashtë vendit, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim të ngushtë me Avokaturën e Shtetit, për të mundësuar arkëtimin e kësaj shume, duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet rrjedhojë e këtij procesi.*

Nga verifikimi pranë Avokaturës së Shtetit mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, rezultoi se midis Avokaturës së Shtetit dhe ish-(MZHETTS), sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pasur korrespondencë në lidhje me këtë problematikë, sikurse shkresat me nr. 8276/2, datë 30.10.2015, me nr. 8291/2, datë 20.11.2015, nr. 2564/1 datë 30.05.2016 dhe nr. 7992/1, datë 14.10.2016, mirëpo në to Avokatura e Shtetit ka kërkuar thjesht marrje informacioni mbi dosjen e privatizimit të A. sh.a, dhe nuk ka këmbengulur të dijë mbi ecurinë për të përshpejtuar dhe mundësuar nga ana ligjore arkëtimin e garancisë së ofertës.

Institucioni i Avokaturës së Shtetit ka pasur dijeni për ***mos arkëtimin e garancisë së privatizimit, në vlerën prej 85 milionë Euro nga kompania V.E. PTE Ltd*** që nga viti 2012. Deri tani, ky institucion, ende nuk ka marrë asnjë veprim ligjor, në bashkëpunim me ish- METE, ish-MZHETTS, tashmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arkëtimin e kësaj vlere, në bazë të ligjit 10018 “Për Avokaturën e Shtetit” datë 13.11.2008 neni 5 pika 1 germa “ë”.

Gjithashtu, Avokatura e Shtetit me shkresa zyrtare, duhej të kishte sensibilizuar dhe tërhequr vëmendjen, që strukturat e larta shtetërore të përfshira në këtë çështje, të mos humbnin kohë, duke iu propozuar atyre mundësitë ligjore për arkëtimin e garancisë së ofertës të paraqitur nga kompania “V.E.PTE Ltd”. Kjo mënyrë veprimi nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë tejkalimin e të gjitha afateve procedurale deri në atë fazë që çështja të kalojë në heshtje dhe të bëhet e pakërkuar, me justifikimin e artificave procedurale administrative të burokracisë së brendshme të institucioneve të Shtetit Shqiptar, *trajtuar më hollësisht në faqen 24, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të verpojë urgjentisht në përmbushje të detyrimeve të saj si dhe nëzbatim të rekomandimeve të mëparshme të lëna nga KLSH me shkresën nr.478/5, datë 05.09.2013.

Për mos arkëtimin e vlerës prej **85 milionë euro** të njoftohet Këshilli i Ministrave, në mënyrë që Avokatura e Shtetit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të marrin masa dhe të përshpejtojnë finalizimin e hapave dhe procedurat ligjore për të mundësuar arkëtimin e garancisë së kontratës nga “V.E.PTE” Ltd, për llogari të Buxhetit të Shtetit.

### **Menjëherë**

**Gjetje 7.** Nga Auditimi mbi vlerësimin e realizimit të aktivitetit për vitin 2016 të Zyrës së Përfaqësimit të Avokaturës së Shtetit, pranë gjykatave shqiptare në nivel kombëtar, u evidentuan raste juridike që kanë sjellë çështje gjyqësore të humbura, në disfavor të Shtetit Shqiptar, të shkaktuara si pasojë e mangësive dhe dobësive të akteve juridike-administrative të institucioneve të administratës publike, të përgatitura nga ***punonjës të pakualifikuar dhe të papërgjegjshëm.***

Kështu përmendim:

- Autoriteti Doganor pranë Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë ka vepruar në kundërshtim me procedurën që përcaktohet qartësisht nga ligji për kryerjen e veprimtarisë hetimore administrative për dhënien e vendimit, aktit, etj., duke mos u komunikuar subjekteve “dyshimet” e tij lidhur me transaksionet e vlerës së mallit, duke mos i dhënë mundësi palës paditëse të shprehet nëse arsyet e dyshimit i kërkon që t’i paraqiten me shkrim, përfshirë edhe projektin e rivlerësimit doganor të njëanshëm të autoritetit doganor. Këto veprime administrative të gabuara janë pasqyruar dhe kanë përbërë bazë arësytimi edhe në vendimet e Kolegjit Administrativ të Gjykatë së Lartë, duke sjellë çështje gjyqësore të humbura.

- Nga Autoriteti Rrugor pranë ish-Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, sot Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës, rezultoi se janë shpronësuar prona të paluajtshme për interesa publike, duke ndryshuar pa të drejtë me veprime administrative regjimin juridik të tokës së shpronësuar nga “tokë arë” në “ tokë truall ”. Për pasojë, kërkesë paditë e pranuar nga gjykatat shqiptare, kanë vendosur që shpërblimi i paditësit(individ ose kompani private) të bëhet me çmimet referuese të përcaktuara në VKM për tokën truall, duke bërë konvertimin e regjimit juridik nga tokë arë në truall, *fakt i cili, ka sjellë vendosjen e një vlere disa herë më të lartë se çmimi i përcaktuar në VKM – të respektive.*

- Nga Autoriteti Shtetëror INUK, janë nxjerrë akte administrative “Për dënim me gjobë” dhe vendime “Për sekuestrimin e mjeteve dhe makinerive”, të marra në kundërshtim me parashikime e neneve 115/b dhe 118 të ligjit të Kodit të Procedurave Administrative, ku në sanksionet e natyrës administrative ligjërish të lejuara për aplikim, përcaktohet gjobë në masën fikse deri në vlerën 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë, ndërsa nga INUK janë vendosur gjoba në vlerën 20.000.000 (njëzet milionë lekë). Kjo masë gjobë është tej kufirit ligjor të parashikuar në nenin 81, të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar. Këto veprime administrative të gabuara janë pasqyruar edhe në vendimet e Kolegjit Administrativ të Gjykatë së Lartë, e për pasojë kanë sjellë çështje

gjqësore të humbura, trajtuar më hollësisht në faqen... të Raportit Përfundimtar të auditimit.

Pra, Avokatura e Shtetit, edhe pse çështjet juridike të situatave të mësipërme i ka përfaqësuar, që në fillim të procedura gjyqësore i ka vlerësuar ato si çështje juridike të humbura, për shkak të mangësive dhe dobësive të akteve juridike-administrative të institucioneve të administratës publike, të përgatitura nga punonjës të pakualifikuar dhe të papërgjegjshëm, duke mbajtur një qëndrim jo efektiv dhe jo eficient. Këto veprime të administratës shqiptare kanë sjellë rëndimin e mëtejshëm të fondeve publike në vlerën prej 69,443,100 lekë, e barazvlefshme kjo me 15 %, të dëmit prej 462,954,000 lekë të shkaktuar në Buxhetin e Shtetit nga çështjet e humbura, *trajtuar më hollësisht në faqet 60-66 të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të marrë masa për realizimin e praktikave zyrtare apo organizimin e tryezave të diskutimit e konsultimit me institucionet respektive, me qëllim shmangien e dëmit pasuror ndaj Shtetit dhe identifikimin e përgjegjësive institucionale dhe individuale për çdo rast.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 8.** Nga auditimi mbi aktivitetin e Zyrës së Këshillimit dhe Koordinimit Ndërmintor si zyrë përgjegjëse për ushtrimin e funksionit këshillimor të Avokaturës së Shtetit për bashkërendimin e punës dhe mbikëqyrjen e avokatëve të Shtetit pranë ministrive, për funksionet këshillimore konstatohet se:

-Për vitin 2017, nuk është hartuar plani i inspektimeve.

- Për kryerjen e inspektimeve në bazë të urdhrave të dalë nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit në disa raste dosjet kanë mangësi dokumentacioni. Konkretisht:

Në dosjen e inspektimit në zbatim të Urdhrit nr.6, datë 03.02.2017 ndaj punës së kryer nga Avokati i Shtetit z. K.S., rezulton se Avokati i Shtetit i caktuar për kryerjen e inspektimit, z. H.M. ka dhënë dorëheqjen nga inspektimi, por në dosje nuk gjendet akti i dorëheqjes.

- Në dosje nuk ka asnjë shkresë mbi procedurën e inspektimit, në ngarkim të këtij avokati.

- Në dosjen e inspektimit në zbatim të Urdhrit nr.36, datë 17.05.2017 ndaj punës së kryer nga Avokati i Shtetit z. E. H., caktuar për kryerjen e inspektimit ndaj Avokatit të Shtetit z. Xh. K., Raporti i Inspektimit është protokolluar me vonesë 1(një) ditë në datë 06.06.2017, duke mos respektuar afatet e vendosura në Urdhrin nr.36, datë 17.05.2017.

- Në Urdhrin nr.36/1, datë 24.7.2017 ka lapsus mes bazës ligjore të shprehur në pjesën arsyetuese për dhënien e masës disiplinore dhe bazës ligjore të shprehur në dispozitiv (pjesa urdhëruese), ndërkohë që edhe masa disiplinore nuk përputhet me llojin e shkeljes. Nga ana tjetër, masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*” nuk i korrespondon natyrës së shkeljes të përcaktuar në nenin 30, pika 1/c.

Mospërputhja midis masës disiplinore dhe shkeljes së konstatuar me ligjin respektiv sjell si pasojë vendosjen e masave disiplinore të pabazuara në dispozitat ligjore, duke ngarkuar me përgjegjësi Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, *trajtuar më hollësisht në faqet 73, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të marrë masa të menjëhershme për hartimin e planit periodik të punës dhe drejtimet mbi të cilat do të ushtrohet inspektimi nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit. Në përfundim të çdo inspektimi, grupi i punës, krahas rekomandimeve, të klasifikojë dhe të vendosë masat disiplinore konform dispozitave ligjore dhe rregullores së brendshme të institucionit.

## Menjëherë

**Gjetje 9.** Nga auditimi mbi aktivitetin e Zyrës së Këshillimit dhe Koordinimit Ndërmëtor si zyrë përgjegjëse për ushtrimin e funksionimit këshillimor të Avokaturës së Shtetit për bashkërendimin e punës dhe mbikëqyrjen e Avokatëve të Shtetit pranë ministrive, në lidhje me zbatimin e funksioneve këshillimore, konstatohet se:

Funksioni këshillimor i Avokaturës së Shtetit është jo efektiv, kundrejt kërkesës për këshillim nga organet e administratës publike, fenomen që konstatohet në sugjerimet që jep ky institucion, e konkretisht:

-Në kërkesat për këshillim dhe dhënje mendimi, adresuar nga ish MZHETTS me shkresat nr.6 924, datë 14.8.2017 dhe nr. 4319, datë 27.4.2017, si dhe nga Agjencia Kombëtare e Ujësllës-Kanalizimeve (AKUK) me shkresën nr. 2069, datë 13.7.2017, Avokatura e Shtetit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të njoftimit të Ministrit të Drejtësisë dhe të Kryeministrit për mos-respektimin e detyrimit për bashkëpunim nga subjektet kërkuese, duke shkelur nenin 16/3 të Ligjit Nr. 10018/2008, *trajtuar më hollësisht në faqet 74-75, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Në këto raste Avokatura e Shtetit të insistojë dhe kërkojë ndihmën e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave.

Avokatura e Shtetit të iniciojë për të përmirësuar ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, duke parashikuar penaltete për zyrtarin përgjegjës në rast të mos-respektimit të detyrimit për bashkëpunim paralelisht me njoftimin për Kryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë, *trajtuar më hollësisht në faqet 20-21, të Raportit Përfundimtar.*

## Menjëherë

**Gjetje 10.** Me shkresën nr.189, datë 30.1.2017, Njësia e Menaxhimit të Projektit Qukës-Qafë Plloçë-ARRSH ka kërkuar mendim në lidhje me propozimin për zëvendësimin e tre anëtarëve të Bordit të Gjykimit të Mosmarrëveshjeve (Dispute Board) me një anëtar të vetëm, për kontratën e lidhur në vitin 2015 për punime civile (FIDIC) për ndërtimin e rrugës “Qukës-Qafë Plloçë”, me qëllim uljen e kostove vjetore për pagesat e këtyre anëtarëve. Avokatura e Shtetit, me shkresën nr.372/1, datë 8.2.2017, sugjeron që “problematikat e trajtuara në shkresë t’i përcillen MTI si organ qendror, ku kjo e fundit ka të drejtën t’i drejtohet Avokaturës së Shtetit, bazuar në nenin 5 dhe 15 të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008. *Për pasojë, mosveprimi, mos-dhënia e këshillimit nga ky institucion, në kundërshtim me nenin 5 dhe 15 të Ligjit, e bën jo efektiv funksionin këshillimor të saj, duke lënë shteg për rritjen artificiale të kostove në Buxhetin e Shtetit.* Kjo, pasi në interpretimin literal të nenit 5 të Ligjit, të drejtën për të marrë mendime/këshillim nga Avokatura e Shtetit e kanë organet e administratës shtetërore qendrore dhe entet publike. Njësia e Menaxhimit të Projektit Qukës-Qafë Plloçë është entitet publik dhe, sipas Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 8, në të cilin në mënyrë eksplicite përcaktohet se: “Të gjitha nivelet e njësive

*publike" është termi që i referohet njësive të përmendura në nenin 3 të këtij ligji dhe nënkupton organin qendror të njësive publike dhe secilën njësi vartëse të konsideruar më vetë", trajtuar më hollësisht në faqen nr. 78-79, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

**Gjetje 11.** Auditimi konstaton se ARRSH, me shkresën, nr. 319, datë 17.01.2017 ka kërkuar nga Avokatura e Shtetit "nëse mund të pranohet aplikimi i kompanisë "S.C. Spa" për t'i realizuar pagesat e situacioneve të ardhshme të pritshme në Itali". Kjo kërkesë e ARRSH-së ka ardhur si pasojë e mosmarrëveshjeve të lindura nga zbatimi i Projekteve "Ndërtim i By Pass-it të Vlorës dhe By Pass-it të Fierit", ku ARRSH, në cilësinë e punëdhënësit, ka lidhur kontrata me kompaninë italiane "S.C. Spa".

Për këtë çështje, midis ARRSH dhe Avokaturës së Shtetit është mbajtur në vijim korrespondencë zyrtare, përmes së cilës është kërkuar opinioni i Avokaturës së Shtetit për përfaqësimin e saj përpara gjykatave italiane nën juridiksionin e të cilave është zgjidhja gjyqësore e mosmarrëveshjeve.

Me shkresën nr. 2365/9, datë 15.11.2017, Avokatura e Shtetit, në lidhje me garancitë e kontratës së By Pass-it të Vlorës, sugjeron që "...Institucioni Juaj të përfaqësohet në seancën e datës 07.12.2017 në Gjykatën e Pordenones, Itali, duke i dhënë një prokurë të posaçme avokatit/studios italiane me të cilën Institucioni juaj ka eksperiencë në çështjen paralel ... deri në zhvillimin e një procedure kontraktimi të përsheptuar....".

Gjithashtu, ARSH me shkresën nr. 10275/1, datë 21.12.2017, në vijim të korrespondencës, kërkon "...përcaktimin e hapave që duhen ndjekur për përfaqësimin e saj në gjykatën e Veronës-Itali, më datë 8 Janar 2018, për kontratën për By Pass-in Fier", në përgjigje të së cilës Avokatura e Shtetit, me shkresën nr.2365/14, datë 22.12.2017 sugjeron se "... institucioni juaj të marrë masa vetë për përfaqësimin në procesin gjyqësor...duke autorizuar një avokat Italian për mbrojtjen e interesave të ARRSH-së.... duke i dhënë një prokurë të posaçme një avokati/studio italiane me të cilin Institucioni ynë ka eksperiencë ....".

Avokatura e Shtetit, në kundërshtim me nenin 15/8 dhe 18/1 të Ligjit 10018/2008 si dhe nenin 11, 12 të VKM nr. 392/2009, mban qëndrime të ndryshme për dy kontratat, në sugjerimet e dhëna prej saj, pasi, pa kurrfarë të drejte dhe kompetence, ka deleguar një prerogativë që është tagër ekskluziv i saj. Për pasojë, delegimi i kompetencës të përzgjedhjes së avokatit, pa kaluar në procedurën e konkurrimit ose pa ia nënshtruar procedurën e lidhjes së kontratës miratimit nga Këshilli i Ministrave, si rast përjashtimor, si dhe pa negociuar më tej kushtet e përfaqësimit dhe vlerën, duke qenë se çështja ka karakter urgjent, sjell efekte negative në Buxhetin e Shtetit (shpenzime për shërbimin e përfaqësimit para gjykatave të huaja), ngarkon me përgjegjësi Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, trajtuar më hollësisht në faqen nr. 78-81, të Raportit Përfundimtar të auditimit.

#### ***Për pikën 10 dhe 11 rekomandoj:***

Avokatura e Shtetit të iniciojë ndryshime ligjore në VKM nr.392,datë 08.04.2009 për kontraktimin e avokatit/studiove avokatore në profesion të lirë, edhe për raste urgjente dhe të paparashikuara.

**Menjëherë**

**Gjetje 12.** Nga auditimi mbi aktivitetin e Zyrës së Përfaqësimit të Avokaturës së Shtetit në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe të arbitrazhit ndërkombëtar, konstatohet se:

Avokatura e Shtetit nuk ka një data base (regjistër) ku të jenë regjistruar: (i) çështjet e iniciuara për arbitrazh nga subjektet e interesuara, ku Republika e Shqipërisë është e përfshirë; (ii) objekti i kërkesës, avokati/studio avokatore vendase/huaj e përzgjedhur për përfaqësimin e çështjes në arbitrazh dhe (iv) Avokati i Shtetit i ngarkuar për përfaqësimin e çështjes në arbitrazh si dhe vendimi i arbitrazhit. Regjistrimi i këtyre të dhënave aktualisht bëhet vetëm nga Zyra e Protokoll-Arkivit, e cila regjistron kërkesën për arbitrazh dërguar nga subjekti i interesuar, duke i bashkëngjitur praktikën referuese si dhe korrespondencën zyrtare institucionale. Për pasojë, Avokatura e Shtetit nuk ka një sistem të saktë të dhënash për kërkesat e regjistruara në arbitrazh, të cilat të shërbejnë si tregues për detyrimet e Shtetit Shqiptar ndaj palëve, ndryshe nga sa paraqitet regjistrimi i të dhënave për çështjet gjyqësore të përfaqësuara nga avokatët e Shtetit në gjykatat kombëtare, ku një database i tillë ekziston dhe në format elektronik, të miratuar nga AKSHI, *trajtuar më hollësisht ne faqen nr. 68, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të fillojë krijimin e një databasse për të pasqyruar të gjitha të dhënat e çështjeve të iniciuara dhe të përfunduara.

Avokatura e Shtetit të iniciojë ndryshime për plotësimin dhe përmirësimin e VKM nr.392, datë 08.04.2009 për të parashikuar detyrimin e Avokaturës së Shtetit për regjistrimin e çështjeve të iniciuara për arbitrazh duke pasqyruar të dhënat mbi objektin e kërkesës, avokatit/studiove avokatore vendase/huaj të përzgjedhur për përfaqësimin e çështjeve në arbitrazh nga Avokati i Shtetit si dhe vendimi i arbitrazhit.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 13.** Nga auditimi mbi aktivitetin e Zyrës së Përfaqësimit në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe të arbitrazhit ndërkombëtar, konstatohet se:

Më datën 25.07.2017, është protokolluar në Avokaturën e Shtetit shkresa 22919/GR e ICC (Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë), ku paditësi kompania “H.SRL” ka filluar një proces të ri arbitrazhi ndaj Republikës së Shqipërisë (shoqëria ka hapur dhe 2 çështje të tjera në vitet paraardhëse). Paditësi ka kërkuar dëmshpërblim sipas detyrimit kontraktor të parashikuar në kontratën koncensionare, në vlerën 103.2 milionë euro, si rezultat i shpronësimit direkt nga projekti i ndërtimit të Hidrocentralit të Kalivaçit (tender i zhvilluar nga ish-MEI në Qershor 2017).

Me shkresën nr.2231/4, datë 08.08.2017, Avokatura e Shtetit kërkon që, në përputhje me nenin 12/2 të VKM nr. 392, datë 08.04.2009, të jepet miratimi paraprak nga këto institucione që janë palë në gjykim, në mënyrë që të fillojë procedura e kontraktimit të avokatit/studios së avokatisë. Për këtë fakt, ajo sjell në kujtesë se “mëqenëse 2 proceset e mëparshme të iniciuara nga paditësi ndaj RSH janë përfaqësuar nga firma avokatisë “G. WLK”, e cila është e familjarizuar me çështjen, sugjeron se është me interes praktik dhe ekonomik, realizimi i shtesës së kontratës me këtë firmë avokatie, kjo, duke marrë në konsideratë dhe afatet e shkurtra në të cilat kërkohet dorëzimi i përgjigjes”.

Për sa sipër, konstatohet:

- MEI nuk ka dhënë miratimin paraprak, sipas kërkesave të nenit 12/2 të VKM nr.392, datë 08.04.2009 për sugjerimin e studios avokatore G.WLK nga Avokatura e Shtetit.

- Me shkresën nr.2231/11, datë 29.8.2017 drejtuar ish Ministrin të Drejtësisë z. G. B., Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në referim të nenit 12/2, të VKM nr. 392, datë

08.04.2009, kërkon miratimin për fillimin e procedurave të kontraktimit të avokatit/studios së avokatisë, duke motivuar nevojën për kontraktimin e tyre, përmes citimit se është “proces mjaft teknik, duke qenë se ndërlidh proceset e koncesionit, pretendimet për shpronësim dhe procesin penal...”. Gjithashtu, Avokatura e Shtetit informon Ministrin e Drejtësisë se MEI dhe MTI, në cilësinë e organeve të interesuara, kanë dhënë dakordësinë e tyre për kontraktimin e shërbimit të përfaqësimit.

Për sa sipër, konstatohet se:

- Referuar shkresës nr. 5549/1, datë 11.8.2017, MEI nuk ka dhënë miratimin paraprak sipas nenit 12/2 VKM nr. 392, datë 8.4.2009, duke e vendosur Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit në kushtet e keqinformimit, pasi miratimi nga ky institucion është dhënë më vonë me shkresën nr. 124/1, datë 22.9.2017, shumë kohë pasi çështja i është referuar Ministrit të Drejtësisë.

- Vlera e propozuar nga studio avokatore “G.WLG” përbëhet nga 995,000 euro, plus 150,000 euro për angazhimin e avokatëve vendorë, në total në shumën prej 1,145,000 euro, është më e lartë se vlera e kontratës bazë për përfaqësimin në çështjen e arbitrazhit ICC 2054/EMT/GR, të firmosur po me këtë studio avokatie.

Për pasojë, vonesat në përzgjedhjen e avokatit/studios së avokatisë të huaj apo dhe miratimit të shtesës së kontratës, rrisin në mënyrë të konsiderueshme kostot në Buxhetin e Shtetit, *trajtuar më hollësisht në faqen 87 të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të hartojë një strukturë analitike të zërave të shpenzimeve për të gjitha rastet e publikuara për kontraktimin e studiove/avokatëve të huaj për mbrojtjen e interesave të Shtetit Shqiptar, me qëllim që në çdo kontratë të lidhur të mos ketë hapësira për rritje të shpenzimeve/kostove të tjera të paparashikuara.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 14.** Nga auditimi u konstatua se gjatë procedurave të konkurrimit të avokatëve/zyrave të avokatisë, Avokatura e Shtetit ka vepruar në kundërshtim me parimin e barazisë në dy procedura konkurrimi (kompania “Anglo-Adriatic Group” LTD kundër Shtetit Shqiptar, dhe kompania “Trans Atlantic Albania” LTD kundër CEZ, sot OSHEE), duke mos vendosur kriterin *“vendi i ushtrimit të aktivitetit duhet të jetë i njëjtë me atë të selisë së organit pranë të cilit kryhet përfaqësimi”*. Gjithashtu, kosto e shërbimit parashikohet në ftesën për negociatë si *“lump sum”*, duke mos u detajuar në zërat përbërës të saj. Mungesa e këtij kriteri mbart risqe që vlera e ofertës, duke mos u analizuar sipas zërave të kostos, mund të sjellë si pasojë kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit, pasi konkurrentët, përveç kostos për shërbimin që do të kryejnë, do të shtojnë edhe koston e udhëtimeve, akomodimit dhe dietave për avokatët e tyre. Mosvënia e këtij kriteri favorizon konkurrentët, të cilët, pavarësisht se nuk e plotësojnë dot kriterin bazë, kualifikohen, edhe pse me çmim më të lartë, duke riskuar të shkaktojnë përdorim joefektiv të fondeve buxhetore. Vlera totale e shpenzimit (në këtë rast si *“lump sum”*), duke mos u reflektuar e detajuar sipas zërave të kostos, nuk na siguron informacion rreth kostove të udhëtimeve dhe dietave të avokatëve që do përfaqësojnë Shtetin Shqiptar në arbitrazhin ndërkombëtar.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM Nr.392, datë 08.04.2009 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet

publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme proceduriale”, neni 13, pika 2, germa a, ku kërkohet vendosja e kriterit “*vendi i ushtrimit të aktivitetit duhet të jetë i njëjtë me atë të selisë së organit pranë të cilit kryhet përfaqësimi*” dhe me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar. Proceset duhet të menaxhohen në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës, *trajtuar më hollësisht nëfaqen 90-101, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Titullari i Avokaturës së Shtetit të marrë masa menjëherë që në procedurat e ardhshme të mos miratojë ftesën për negociata, pa u vendosur ky kriter, sikurse parashikohet në VKM Nr.392, datë 8.4.2009, si dhe që kriteri “çmim” të mos kërkohet si “lump sum”, por i detajuar në zërat e kostos.

**Gjetje 15.** Nga auditimi i procedurës së konkurrimit të zyrave të avokatisë për përfaqësimin e Shtetit Shqiptar në arbitrazhin ndërkombëtar kundër kompanisë “A. A.” LTD Group, u konstatua se:

1. Kompania paditëse nuk ka aplikuar për ri-licensimin e bonove të privatizimit tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sikurse parashikohet në nenin 55 të ligjit 10198, datë 10.12.2009.
2. Pala paditëse ka rritur artificialisht vlerën e dëmshpërblimit që kërkon në arbitrazh, pasi sipas të dhënave të INSTAT, rritja e GDP-së varion nga 2.5-3.5 % dhe jo 10 % si pretendohet, duke rritur rreth 3.5 herë vlerën e dëmshpërblimit nga 74,690,078 USD në shumën prej 224,070,235 USD, ose 149,380,157 USD më tepër.
3. Nuk ka asnjë të dhënë apo informacion për veprimtarinë e kësaj kompanie, në lidhje me përdorimin e bonove të privatizimit të emetuara nga Shteti dhe të grumbulluara nga shoqëria “A.A.I. F.”, nga të cilat 40 % i disponon kompania paditëse (“A.A.G.” LTD).
4. Në ekstraktin historik i QKB-së, ndonëse të paplotësuar me të dhëna në të gjitha rubrikat e tij, rubrika 18 e këtij formulari tregon se kompania është me status aktiv.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bazë të sistemit informatik, vërteton se ky subjekt nuk ka deklaruar të ardhura nga periudha 1996 deri më 2003 dhe ka kaluar me status pasiv në datën 10.09.2003.

Këto të dhëna mjaftojnë për të krijuar bindjen se jemi në kushtet e mungesës së legjitimitetit të palës, për t’iu drejtuar arbitrazhit ndërkombëtar, ndaj këtë çështje me kaq shumë fakte në favor të Shtetit Shqiptar mund ta përfaqësonte vetë Avokatura e Shtetit, dhe jo të rekrutonte avokatë/zyrë avokatie, duke sjellë si pasojë përdorimin pa efektivitet të vlerës prej **2,000,000 euro**, *trajtuar më hollësisht në faqet 90-101, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

**Gjetje 16.** Nga auditimi i çështjes në arbitrazh SCAI CASE NO. 600491-2017, CEZ kundër EFT (E.F.T.), u konstatua se “CEZ Shpërndarje” dhe “EFT” më datë 22.12.2011 kanë nënshkruar një kontratë për furnizim me energji elektrike për periudhën 01 Janar deri më datë 31 Dhjetor 2012. Sipas parashikimeve kontraktore, “CEZ Sh.” duhet t’i paguante “EFT” energjinë e lëvruar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të lëvrimin. Sipas pretendimeve të paditësit, duke filluar nga shkurti i vitit 2012 e në vijim, “CEZ Sh.” nuk



ka paguar energjinë e lëvruar, në shkelje të parashikimeve kontraktore. Në datën 3 Korrik 2012, EFT informoi “CEZ Sh.” që për shkak të mos pagesës së faturave të energjisë së lëvruar, nuk do ta furnizonte më me energji, për arsye të vështirësisë financiare që po kalonte. “EFT” në verën e vitit 2012, nga data 17 Gusht 2012, pezulloi furnizimin me energji elektrike. Disa javë më vonë, palët ranë dakord që “CEZ Sh.” do të bënte pagesa paraprake për energjinë dhe, më tej do të furnizohej nga “EFT”, 2 ditë nga konfirmimi i kryerjes së pagesave nga “CEZ Sh.”.

Për shkak se “CEZ Sh.” nuk arriti të bënte parapagimin e energjisë që do të lëvrohej më datë 27 Shtator 2012, “EFT” pezulloi furnizimin me energji elektrike deri në përfundimin e kontratës, pra më datë 31 Dhjetor 2012. Detyrimi i papaguar për periudhën nga Janari deri në muajin Shtator të vitit 2012 është paguar nga “CEZ Sh.” në muajin Gusht 2013.

Për sa më sipër, objekti i kërkesës për arbitrazh është vetëm për energjinë që nuk është lëvruar nga “EFT”, si rezultat i shkeljes së kushteve kontraktore nga “CEZ Sh.” sha.

Nga auditimi i tre çështjeve të mësipërme (“A.-A. G. Limited kundër Shtetit Shqiptar dhe “T.A.A.” Ltd kundër CEZ, sot OSHEE dhe CEZ kundër “EFT”) u konstata se këto çështje nuk kanë natyrë të veçantë dhe të ndërlikuar juridike, pasi referuar fakteve të evidentuara edhe më lart, ato janë të thjeshta (jo teknike), çka nënkupton që Avokatura e Shtetit duhej ta kishte përfaqësuar vetë Shtetin Shqiptar në arbitrazhin ndërkombëtar kundër AAGL, Trans Atlantic Albania Ltd dhe EFT, në mënyrë që të mos e rëndonte Buxhetin e Shtetit me pagesën ndaj zyrës së huaj të avokatisë.

Kështu, për rastin AAGL kundër Shtetit Shqiptar, zyra e avokatisë do t’i kushtojë Shtetit Shqiptar **2.000.000 euro**; në rastin Trans Atlantic Albania Ltd kundër MEI, AKBN, dhe A. SH.A, zyra e avokatisë do t’i kushtojë Shtetit Shqiptar **1.400.000 euro** dhe për rastin CEZ kundër EFT, zyra e avokatisë do t’i kushtojë Shtetit Shqiptar **340.000 euro**. **Gjithsej, rritja artificiale e koston së buxhetit është në vlerën prej 3,740,000 Euro**. Kjo kosto tepër e lartë për Buxhetin e Shtetit vjen si rrjedhojë thjesht e mosmarrjes përsipër nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit për të përfaqësuar Shtetin Shqiptar në arbitrazhet ndërkombëtarë, duke u përpjekur të justifikohet pas faktit se janë çështje me karakter të veçantë.

Shkelja e kushteve të kontratës nuk përbën veçanti që të lindë nevoja e rekrutimit të avokatëve apo zyrave të avokatisë, e sidomos atyre të huaja, të cilat, për më tepër nuk e njohin legjislacionin e Shtetit Shqiptar më mirë se vetë Avokatura e Shtetit. Ajo që bie në sy dhe që nuk ka asnjë logjikë juridike dhe ekonomike, është fakti se zyrat shqiptare të avokatisë nuk kanë fituar në asnjë rast, ndërkohë që, përveç faktit që eksperiencia e këtyre zyrave në lidhje me çështje që i përkasin legjislacionit shqiptar është më e madhe se ajo e zyrave të huaja, edhe kosto financiare, për Buxhetin e Shtetit, nëse do të angazhohej një zyrë avokatie vendase do të ishte shumë më e ulët, në krahasim me një zyrë avokatie të huaj.

Për më tepër, Avokatura e Shtetit shfaqet si një institucion tejet inefiçient, pasi është shndërruar në një subjekt që realizon procedura konkurrimi për rekrutim studiosh të huaja, duke mos përmbushur objektivin kryesor, mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të Shtetit Shqiptar, *trajtuar më hollësisht në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

***Për këtë rekomandoj:***

Të merren masa nga Avokati i Përgjithshëm që në rastet pasardhëse ku nevojitet përfaqësimi i Shtetit Shqiptar në arbitrazh ndërkombëtar, përfaqësimi të kryhet nga vetë Avokati i Përgjithshëm. Në ndihmë të punës së Avokatit të Përgjithshëm mund të thirren për asistencë specialistë apo ekspertë me njohuri të posaçme të fushës kur çështjet kanë lidhje me fusha si energjetika, ekonomia apo shkenca të tjera specifike ku Avokati i Përgjithshëm e ka të nevojshme për shkak të mos njohjes, por jo ti drejtohet në mënyrë absolute zgjidhjes me rekrutim avokatesh/studio avokatësh të huaja.

Për çdo rast kur kërkohet mbrojtje e çështjeve në arbitrazhet ndërkombëtare, Avokatura e Shtetit të kontraktojë studio ligjore avokatie apo konsulence, nëpërmjet realizimit të procedurave të konkurrimit dhe paraprakisht mbështetur në fondet publike që ka në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, ose të garantuara nga subjektet publike që kanë interesa dhe janë palë në arbitrazh.

Për çdo rast të kontraktimit të studiove ligjore avokatie apo konsulence për mbrojtje të çështjeve në arbitrazhet e ndryshme ndërkombëtare nëpërmjet konkurrimit, Avokatura e Shtetit të bashkëpunojë ngushtë me subjektet publike që janë palë në këto çështje për hartimin e dokumenteve të konkurrimit, (kriterëve të përgjithshme, kriterëve specifike dhe kushtet e kontratave).

**Menjëherë**

## **C.I. REKOMANDIME PËR MASA ZHDENTIMI**

**Gjetje 1.** Për vitin 2016 Avokatura e Shtetit ka marrë me qira një ambient pune për Degën e Avokaturës Rajonale Korçë nga subjekti fizik privat R.Th., (Bar-kafe, fast-food) me numër nipti L23801006E. Marrja me qira e objektit nga ASH është bërë pa procedure prokurimi, pa përcaktuar sipërfaqen e objektit në kundërshtim me ligjin nr. 9643 “Për procedurat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për këtë objekt, Avokatura e Shtetit ka xhiruar në llogarinë likuiduese të subjekti privat vlerën totale prej 210,000 lekë, pa ndalur tatimin në burim në masën 15 % ndaj subjektit përfitues në shumën **31,500 lekë** (210,000 x 15 %), në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8 të ardhurat e tatueshme, kreu IV “Tatimi i mbajtur në burimin e të ardhurave, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, *trajtuar më hollësisht në faqen 12 të Raportit Përfundimtar.*

### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Marrjen e masave për të arkëtuar sipas dispozitave ligjore vlerën prej 31,500 lekë, nga subjekti privat R.Th. dhe vlera e arkëtuar të xhirohet në Degën e Tatim Taksave.

**Menjëherë**

**Gjetje 2.** Me urdhër shpenzimin nr.184, datë 08.07.2016, nënshkruar nga znj. A.H., në cilësinë e nëpunësit autorizues, është likuiduar agjencia “A.T.&T.” Tiranë në shumën prej 361,950 lekë, për shpenzim udhëtim e dieta, (rast emergjent). Shërbimi jashtë shtetit është kryer sipas Autorizimit nr. 4160/1, datë 07.06.2016 nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë,

me të cilin autorizohet znj. A.H. dhe znj. B.L. për të marrë pjesë në zyrën e përfaqësimit në gjykatat e huaja dhe arbitrazhin ndërkombëtar në Londër. Sipas urdhrin miratuar datë 14.06.2016, komisioni i blerjeve me vlera të vogla (A.H., E.D. dhe J. D.), po në datën 14.06.2016 ka realizuar këtë shërbim me **“procedurë blerje emergjente”**.

Nga verifikimi i dokumentacionit krahasuar me Urdhrin e Ministrit, në praktikën e këtij shërbimi u gjend një biletë udhëtimi e znj. H. në linjën ajrore Washington Londër, e cila nuk justifikon shpenzimin e kryer për linjën Tiranë-Londër me vlerë **358 euro**.

Pagesa prej 385 Euro, për biletën e znj. H. është e pajustificuar me Autorizimin e Ministri i Drejtësisë nr. 4160/1, datë 07.06.2016 dhe është në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit, pika 11, ku përcaktohet *“Shpenzimet e transportit, të fjetjes dhe pagesat e tjera, në të gjitha rastet, njihen dhe paguhen sipas dokumentit përkatës justifikues”*(në vend të biletës Tiranë-Londër, u gjend bileta Tiranë-Washington-Londër), *trajtuar më hollësisht në faqen 14 të Raportit Përfundimtar.*

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Marrjen e masave sipas dispozitave ligjore për arkëtimin e vlerës prej **385 Euro** nga znj. A.H., (në cilësinë e nëpunësit autorizues) pasi shpenzimet e udhëtimit në linjën Tiranë-Londër (dublim shpenzimi), nuk justifikohen me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. nr. 4160/1, datë 07.06.2016.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 3.** Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve sipas kontratës së lidhur me objekt “Rikonstruksion i ambienteve të punës së Avokaturës së Shtetit”, konstatohet se me urdhër shpenzimin nr. 314, datë 29.12.2017 është likuiduar situacioni përfundimtar i paraqitur nga shoqëria sipërmarrëse K.A.E.XH. në shumën prej 27,200,106 lekë për rikonstruksionin e zyrave të Avokatit të Shtetit.

Nga auditimi i zërave të preventivit dhe situacionit përfundimtar, konstatohet se zëri me Analize nr. 2.426 “Prishje muri tulle”, që përbëhet nga nënzërat e prishje muri gipsi, prishje suva, prishje shtresa pllaka, në përllogaritjen e fondit limit të miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, nuk janë llogaritur në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, *trajtuar më hollësisht në faqen 18-19 të Raportit Përfundimtar.*

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Marrjen e masave për të kërkuar sipas dispozitave ligjore arkëtimin e vlerës prej **111,888 lekë**, nga shoqëria sipërmarrëse Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “K.A.E.XH.”, për sa përfituar padrejtësisht në rikonstruksionin e objektit zyrtar e reja të Avokaturës së Shtetit .

#### **Menjëherë**

### **C.II. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**Gjetje 1.** Nga auditimi i procedurës së konkurrimit të zyrave të avokatisë për përfaqësimin e Shtetit Shqiptar në arbitrazhin ndërkombëtar kundër kompanisë “A.A.” LTD Group, u konstatua se:

1. Kompania paditëse nuk ka aplikuar për ri-licensimin e bonove të privatizimit tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sikurse parashikohet në nenin 55 të ligjit 10198, datë 10.12.2009.
2. Pala paditëse ka rritur artificialisht vlerën e dëmshpërblimit që kërkon në arbitrazh, pasi sipas të dhënave të INSTAT, rritja e GDP-së varion nga 2.5-3.5 % dhe jo 10 % si pretendohet, duke rritur rreth 3.5 herë vlerën e dëmshpërblimit nga 74,690,078 USD në shumën prej 224,070,235 USD, ose 149,380,157 USD më tepër.
3. Nuk ka asnjë të dhënë apo informacion për veprimtarinë e kësaj kompanie, në lidhje me përdorimin e bonove të privatizimit të emetuara nga Shteti dhe të grumbulluara nga shoqëria “A.A.I. F.”, nga të cilat 40 % i disponon kompania paditëse (“A.A.G.” LTD).
4. Në ekstraktin historik i QKB-së, ndonëse të paplotësuar me të dhëna në të gjitha rubrikat e tij, rubrika 18 e këtij formulari tregon se kompania është me status aktiv.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në bazë të sistemit informatik, vërteton se ky subjekt nuk ka deklaruar të ardhura nga periudha 1996 deri më 2003 dhe ka kaluar me status pasiv në datën 10.09.2003.

Këto të dhëna mjaftojnë për të krijuar bindjen se jemi në kushtet e mungesës së legjitimitetit të palës, për t’iu drejtuar arbitrazhit ndërkombëtar, ndaj këtë çështje me kaq shumë fakte në favor të Shtetit Shqiptar mund ta përfaqësonte vetë Avokatura e Shtetit, dhe jo të rekrutonte avokatë/zyrë avokatie, duke sjellë si pasojë përdorimin pa efektivitet të vlerës prej **2,000,000 euro**, *trajtuar më hollësisht në faqen 90-101, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

**Gjetje 2.** Nga auditimi i çështjes në arbitrazh SCAI CASE NO. 600491-2017, CEZ kundër EFT (Energy Financing Team), u konstatua se “CEZ Sh.” dhe “EFT” më datë 22.12.2011 kanë nënshkruar një kontratë për furnizim me energji elektrike për periudhën 01 Janar deri më datë 31 Dhjetor 2012. Sipas parashikimeve kontraktore, “CEZ Shpërndarje” duhet t’i paguante “EFT” energjinë e lëvruar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të lëvrimit. Sipas pretendimeve të paditësit, duke filluar nga shkurti i vitit 2012 e në vijim, “CEZ Sh.” nuk ka paguar energjinë e lëvruar, në shkelje të parashikimeve kontraktore. Në datën 3 Korrik 2012, EFT informoi “CEZ Sh.” që për shkak të mos pagesës së faturave të energjisë së lëvruar, nuk do ta furnizonte më me energji, për arsye të vështirësisë financiare që po kalonte. “EFT” në verën e vitit 2012, nga data 17 Gusht 2012, pezulloi furnizimin me energji elektrike. Disa javë më vonë, palët ranë dakord që “CEZ Sh.” do të bënte pagesa paraprake për energjinë dhe, më tej do të furnizohej nga “EFT”, 2 ditë nga konfirmimi i kryerjes së pagesave nga “CEZ Sh.”.

Për shkak se “CEZ Sh.” nuk arriti të bënte parapagimin e energjisë që do të lëvrohej më datë 27 Shtator 2012, “EFT” pezulloi furnizimin me energjisë elektrike deri në përfundimin e kontratës, pra më datë 31 Dhjetor 2012. Detyrimi i papaguar për periudhën nga Janari deri në muajin Shtator të vitit 2012 është paguar nga “CEZ Sh.” në muajin Gusht 2013.

Për sa më sipër, objekti i kërkesës për arbitrazh është vetëm për energjinë që nuk është lëvruar nga “EFT”, si rezultat i shkeljes së kushteve kontraktore nga “CEZ Sh.” sha.

Nga auditimi i tre çështjeve (“Anglo-Adriatic Group Limited kundër Shtetit Shqiptar dhe “T.A.A.” Ltd kundër CEZ, sot OSHEE dhe CEZ kundër “EFT”) u konstatua se këto çështje nuk kanë natyrë të veçantë dhe të ndërlikuar juridike, pasi referuar fakteve të evidentuara edhe më lart, ato janë të thjeshta (jo teknike), çka nënkupton që Avokatura e Shtetit duhej

ta kishte përfaqësuar vetë Shtetin Shqiptar në arbitrazhin ndërkombëtar kundër AAGL, T.A.A.Ltd dhe EFT, në mënyrë që të mos e rëndonte Buxhetin e Shtetit me pagesën ndaj zyrës së huaj të avokatisë.

Në të dy gjetjet e mësipërme evidentohet se, për rastin AAGL zyra e avokatisë do t'i kushtojë Shtetit Shqiptar **2.000.000 euro**; në rastin Trans Atlantic Albania Ltd kundër MEI, AKBN, dhe A. SH.A, zyra e avokatisë do t'i kushtojë Shtetit Shqiptar **1.400.000 euro** dhe për rastin CEZ kundër EFT, zyra e avokatisë do t'i kushtojë Shtetit Shqiptar **340.000 euro**. **Gjithsej, rritja artificiale e koston së buxhetit është në vlerën prej 3,740,000 Euro**. Kjo kosto tepër e lartë për Buxhetin e Shtetit vjen si rrjedhojë thjesht e mosmarrjes përsipër nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit për të përfaqësuar Shtetin Shqiptar në arbitrazhet ndërkombëtarë, duke u përpjekur të justifikohet pas faktit se janë çështje me karakter të veçantë.

Shkelja e kushteve të kontratës nuk përbën veçanti që të lindë nevoja e rekrutimit të avokatëve apo zyrave të avokatisë, e sidomos atyre të huaja, të cilat, për më tepër nuk e njohin legjislacionin e Shtetit Shqiptar më mirë se vetë Avokatura e Shtetit. Ajo që bie në sy dhe që nuk ka asnjë logjikë juridike dhe ekonomike, është fakti se zyrat shqiptare të avokatisë nuk kanë fituar në asnjë rast, ndërkohë që, përveç faktit që eksperiencia e këtyre zyrave në lidhje me çështje që i përkasin legjislacionit shqiptar është më e madhe se ajo e zyrave të huaja, edhe kosto financiare, për Buxhetin e Shtetit, nëse do të angazhohej një zyrë avokatie vendase do të ishte shumë më e ulët, në krahasim me një zyrë avokatie të huaj, *trajtuar më hollësisht në faqet 90-105 të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

#### **Për gjetjen 1 dhe 2 rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet, pa ekonomikitet dhe pa efizienz të fondeve buxhetore në vlerën prej **3,740,000 euro** dhe të nxjerrë përgjegjësitë për çdo rast, në mënyrë që mbrojtja e interesave të shtetit shqiptar në të ardhmen të kryhet nga Avokatët e Shtetit, në ato raste kur është e gjithë ekspertiza e nevojshme dhe jo të kthejë angazhimin e studiove/avokatëve të huaja në qëllim në vetvete duke shpenzuar jo me efizienz dhe efektivitet fondet publike.

**Menjëherë**

### **C.III. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË DËM TË BUXHETIT TË SHETIT**

**Gjetje 1.** Nga auditimi për zbatimin e rekomandimeve të mëparshme të KLSH (me shkresë të KLSH me nr.264/8, datë 12.10.2015), në lidhje me arkëtimin e garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “V.E. PTE Ltd” për procedurën e zhvilluar për privatizimin e shoqërisë “A.” sha, Patos”, KLSH ka rekomanduar: *“Të vazhdojë me përparësi ndjekja e procedurave ligjore brenda dhe jashtë vendit, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim të ngushtë me Avokaturën e Shtetit, për të mundësuar arkëtimin e kësaj shume, duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet rrjedhojë e këtij procesi.*

Nga verifikimi pranë Avokaturës së Shtetit mbi statusin e zbatimit të këtij rekomandimi, rezultoi se midis Avokaturës së Shtetit dhe ish-(MZHETTS), sot Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka pasur korrespondencë në lidhje me këtë problematikë, sikurse shkresat

me nr. 8276/2, datë 30.10.2015, me nr. 8291/2, datë 20.11.2015, nr. 2564/1 datë 30.05.2016 dhe nr. 7992/1, datë 14.10.2016, mirëpo në to Avokatura e Shtetit ka kërkuar thjesht marrje informacioni mbi dosjen e privatizimit të A. sh.a, dhe nuk ka këmbengulur të dijë mbi ecurinë për të përshpejtuar dhe mundësuar nga ana ligjore arkëtimin e garancisë së ofertës.

Institucioni i Avokaturës së Shtetit ka pasur dijeni për **mos arkëtimin e garancisë së privatizimit, në vlerën prej 85 milionë Euro nga kompania V.E. PTE Ltd** që nga viti 2012. Deri tani, ky institucion, ende nuk ka marrë asnjë veprim ligjor, në bashkëpunim me ish- METE, ish-MZHETTS, tashmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për arkëtimin e kësaj vlere, në bazë të ligjit 10018 “Për Avokaturën e Shtetit” datë 13.11.2008 neni 5 pika 1 germa “ë”.

Gjithashtu, Avokatura e Shtetit me shkresa zyrtare, duhej të kishte sensibilizuar dhe tërhequr vëmendjen, që strukturat e larta shtetërore të përfshira në këtë çështje, të mos humbnin kohë, duke iu propozuar atyre mundësitë ligjore për arkëtimin e garancisë së ofertës të paraqitur nga kompania “V.E. PTE Ltd”. Kjo mënyrë veprimi nga Avokatura e Shtetit, ka sjellë tejkalimin e të gjitha afateve procedurale deri në atë fazë që çështja të kalojë në heshtje dhe të bëhet e pakërkuar, me justifikimin e artificave procedurale administrative të burokracisë së brendshme të institucioneve të Shtetit Shqiptar, *trajtuar më hollësisht në faqen 24, të Raportit Përfundimtar të auditimit.*

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mosveprimin me qëllim arkëtimin e të ardhurave në favor të buxhetit **në vlerën 85 milionë Euro**, si dhe të investohet tërësisht dhe urgjentisht në këtë çështje.

**Menjëherë**

**Gjetje 2.** Nga auditimi për respektimin e dispozitave ligjore për përzgjedhjen e 3 studiove avokatie të huaja, me objekt mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar me oferta në vlerën prej 2,340,000 euro (nga të cilat 1 kontratë nuk është lidhur), konstatohet se në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8 të ardhurat e tatueshme, kreu IV “Tatimi i mbajtur në burimin e të ardhurave, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” pika 1, nuk është parashikuar ndalesa e tatimit në burim në masën 15 % në shumën **351,000 Euro** mbi të ardhurat që do realizohen, duke sjellë si pasojë evazion fiskal për të ardhurat tatimore në RSH, *trajtuar në faqen 111 të Raportit përfundimtar të Auditimit.*

**Për sa më sipër rekomandoj:**

Avokatura e Shtetit të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mosarkëtimin e të ardhurave në favor të buxhetit **në vlerën 351,000 Euro**.

**Menjëherë**

**D. MASA DISIPLINORE DHE TË TJERA**

1. Mbështetur në nenin 31 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i rekomandojmë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, që brenda muajit shtator 2018, të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin nëpunës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje me shkrim”, “Vërejtje me Paralajmërim” deri në “Shkarkim nga detyra”.

2. Duke pasur parasysh rëndësinë, specifikat dhe problematikat e institucionit të Avokatit të Shtetit në mbrojtjen e interesave të institucioneve dhe aseteve publike, si dhe të fondeve të Buxhetit të Shtetit, përmbi të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara nga ky auditim do të përcjellim pranë, Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Ministrave, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet përkatëse.

Është e pakonceptueshme që një institucion si Avokati i Shtetit të angazhojë kompani private konsulence pa lidhur kontrata paraprake me to, në shkelje të plotë dhe flagrante të legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe të angazhojë kompani private shërbimi, kur vetë i ka të gjitha burimet njerëzore dhe zotëron ekspertizën e duhur për fusha të caktuara të veprimtarisë shtetërore dhe publike.

Mbështetur në nenin 26 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i rekomandojmë, Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave që, në varësi të shkallës së përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të analizoj Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimin përkatës, dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga, “Vërejtje me shkrim”, “Vërejtje me Paralajmërim” deri në “Shkarkim nga detyra” apo masa për ndjekje penale, për secilin punonjës, nga niveli më i ulët deri te Avokatit i Përgjithshëm i Shtetit.

Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave duhet që urgjentisht të plotësojnë dhe përmirësojnë Ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” dhe të paraqiten për miratim në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe aktet nënligjore përkatëse në zbatim të tij.

## **E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE**

KLSH do të ndjekë me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë masat që do të marrë Avokati i Shtetit, Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave për zbatimin e rekomandimeve të këtij auditimi, reflektimin e tyre dhe përmirësimin e punës dhe proceseve në mbrojtje të interesave të Shtetit dhe taksapaguesve shqiptarë.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit, si nga Avokatura e Shtetit, ashtu dhe nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave.

Raporti Përfundimtar i Auditimit sëbashku me rekomandimet përkatëse i përcillen: Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**